

**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

N r.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	<b>Ekspert (për Inovacionin)</b>	Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes	Tiranë	Pa afat	Po	Po	21.12.2023	04.01.2024
2								
3								

Formulari nr. 1

<b>1.Pozicioni i punës: Ekspert (për Inovacionin),</b> në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
<b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A
<b>3. Reparti/Institucioni:</b> Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
<b>4. Vendi:</b> Tiranë
<b>5. Paga:</b> VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar (II-1)
<b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat
<b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 21.12.2023
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 04.01.2024
<b>9. Mënyra e aplikimit:</b>  Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a> . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në:  <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i>  <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i>  <i>Tiranë</i>

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al) (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Ekspert (për Inovacionin), në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.
- b. Arsimi: Të ketë diplomë të nivelit ekuivalente “Master Shkencor”, në Shkenca ekonomike, shkenca kompjuterike, administrim biznesi, informatikë ekonomike, Informatikë, Teknologji Informacioni.
- c. Kualifikimi: Të ketë kualifikime në fushën e mësipërme.
- d. Trajnimi: Të ketë kryer trajnime të tjera që lidhen me kërkimin dhe zhvillimin.
- e. Eksperienca në Punë: Eksperienca jo më pak se 5 vjet në kërkim dhe zhvillim si dhe në menaxhim të palëve të interesit.
- f. Gjuha e huaj: Anglisht
- g. Kërkesa të tjera specifike: Ekspertizë në analizimin e të dhënave statistikore. Aftësi për të

përdorur programe të menaxhimit të projekteve, si Microsoft Project, Trello, Asana, Jira, programe të komunikimit dhe bashkëpunimit, si Skype, Zoom, Slack përdorur programe të analizës së të dhënave, si Excel, R, Python, ArcGIS, QGIS, Erdas Imagine, SQL.

- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Te plotesoje kriteret për tu pajisur me certifikate të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015. Certifikate Sigurie “Secret”.

### **Detyrat kryesore:**

- Identifikon tematika të ndryshme për tu fokusuar për kërkim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
- Vepron si një katalizator për ndryshimin dhe përmirësimin e performancës dhe cilësisë përmes teknologjive të reja.
- Ofron të dhëna dhe trajnime për metodologjinë për inovacion, identifikimin e teknikave dhe teknologjive të reja.
- Harton dhe mirëmban manualin operativ të qendrës, duke siguruar të gjitha procedurat janë të përditësuara dhe të dokumentuara.
- Ndjek zhvillimet e Qendrave të Testimit të DIANA dhe merr pjesë në aktivitete të fushës.
- Bashkëpunon me IKSHU për të zhvilluar ide të reja nëpërmjet metodave të ndryshme të kërkimit dhe Zhvillimit.
- Identifikimi i thirrjeve dhe projekteve të ndryshme për kërkimin shkencor dhe inovacion.
- Ngritja e bashkëpunimit me universitete, institucione, kompani, individë dhe qendra të tjera që merren me inovacion dhe kërkim shkencor.
- Bashkëpunimi me ekspertin e komunikimeve dhe organizimin e eventeve për organizimin e trajnimeve apo seminarëve të ndryshme që lidhen me nevojën për kërkim dhe zhvillim si dhe prezantimeve nga profesioniste të jashtëm të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes.
- Bashkëpunon me Akademinë e Forcave të Armatosura për shkëmbimin e eksperiencave dhe njohurive, zgjerimin e kurrikulave.
- Bashkëpunon me ministritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë kombëtare sektoriale në fushën e shkencës dhe inovacionit, për sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes;
- Mbështetja e shkëmbimit të njohurive dhe krijimi i rrjetëzimit dhe grupimit të palëve të interesuara në fushën e sigurisë mbrojtjes.
- Ofrimi i mundësisë për përdoruesit e Qendrës që të ndërveprojnë me zhvilluesit dhe studiuesit e sistemeve dhe të mësojnë më shumë rreth zgjidhjeve inovative.
- Organizimi i sesioneve brainstorming me kërkuesit shkencor.
- Kryen kërkime për të identifikuar teknologjitë e reja ose tendencat e në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
- Rekomandon ndryshime në produkte, shërbime ose procese për të përmirësuar efikasitetin dhe për të ulur kostot pa sakrifikuar cilësinë.
- Zhvillon prototipe për të testuar idetë ose konceptet e reja përpara se ato të zbatohen.
- Kryen hulumtime të tregut për të identifikuar mundësitë për produkte ose shërbime të reja që plotësojnë nevojat për siguri dhe mbrojtje.
- Zhvillon plane strategjike për lançimin e produkteve të reja ose fushatat e marketingut që përputhen me qëllimet qendres.

- Harton, implementon dhe menaxhon planin e punës për fushën që mbulon.
- Harton skema dhe grafike për të gjeneruar raporte sipas nevojave;
- Krijon dhe mirëmban bazat e të dhënave dhe informacioneve për të cilat është përgjegjës.
- Siguron raporte të qarta dhe në kohë për statusin e zhvillimit të trajnimeve, seminareve nevojave dhe detaje të tjera relevante;
- Mbështet diskutimet teknike me koleget dhe eprorin gjatë fazës së zbatimit;
- Raporton në mënyrë periodike tek eprori direkt për zhvillimet në qendër.
- Kryen detyra të tjera përkatëse që i ngarkohen nga drejtori i qendrës.

### 13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtorja e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimi (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;

- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidati i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.